

ALEKSANDAR TIŠMA

LIBRI I BLAMIT

ROMAN

BOTIMET TOENA

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale e Evropës, Integritimit dhe Punëve të Jashtme në Republikën e Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni Zviceran Pro Helvetia, Grupi i Interesit të Përkthyesve dhe Përkthyesve (Shtëpia e Letërsisë Vjenë) me porosi të Ministrisë Federale të Artit, Kulturës, Shërbimeve Publike dhe Sportit në Republikën e Austrisë, Instituti Goethe, Agjencia Sllovene e Librit, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe Informacionit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Kulturës e Republikës së Bullgarisë, Panairi i Librit në Lajpcig dhe Fondacioni S. Fischer.

ALEKSANDAR TIŠMA

LIBRI I BLAMIT

Përktheu nga origjinali serbisht
Ben Andoni

BOTIMET TOENA
Tiranë

Autori: Aleksandar Tišma
Titulli në origjinal: Knjiga o Blamu
Botoi në serbisht: Nolit, Beograd

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi
Redaktor letrar: Eris Rusi
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817150

© e përkthimit: Fondacioni S. Fischer me porosi të TRADUKIT
© Aleksandar Tišma, 1985
Translated from the Serbo-Croatian language: KNJIGA O BLAMU
© në *shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

I

Pallati Mërkur është ngrehina më e spikatur në Novi Sad. Vërtet jo më e larta, sepse tashmë është mposhtur nga shumëkatëshet vertikale akullnajore dhe kurorat e gërshetuara të blloqeve të banimit, të cilat i vargëzoi dyndja e popullsisë së pasluftës ngulur mbi kullotat në skaj të qytetit. Por ama s' ishte edhe më tërheqësja, për shkak se krijuesi dhe pronari i saj i parë, një biznesmen i paraluftës, duke e konsideruar thjesht si një sipërmarrje qiraje, i shfrytëzoi maksimalisht çdo mundësi hapësire, duke iu shmangur zbukurimeve të kushtueshme. E megjithatë, pallati Mërkur, duke e zgjatur fasadën futej kah Sheshit Kryesor me njërin nga këndet e rumbullakosura, si të ishte kiçi i ndonjë anije të linjës oqeanike përgjatë Bulevardit të Vjetër, me lartësinë tërheqëse katërkatëshe të gjerë e të drejtë dhe me papafingon ngushtuar në formën e një kuverte, duke funksionuar me një rresht të pandërprerë biznesesh vendosur në katin përdhë, mes të cilave përfshiheshin një dyqan mallrash, kinemaja dhe hoteli me restorant dhe bar, duke e imponuar në këtë mënyrë ngrehinën, nga ku mund të shihej pa asnjë

mëdyshje si të ishte pika qendrore e padiskutueshme e qytetit.

Miroslav Blami, i cili banon në papafingon e Mërkurit, është i përshtatur me pozicionin e veçantë e të lartësuar të ndërtesës dhe të qenët edhe vetë si pjesë përbërëse e saj. Është krenar për statusin e tij, ndonëse nuk e tregon, e madje rri pakëz si i tërhequr, pasi nuk e ka marrë me meritën e vet. Kur i duhet të shkruajë adresën në anën e pasme të zarfit, për ta hedhur pastaj në kutinë postare, nuk përdor atë që përdoret nga të gjithë si identifikim “Pallati Mërkur” (adresa lidhet me emrin e pronarit të kompanisë); por shfrytëzon atë më zyrtaren, edhe pse duket pak më e komplikuar Bulevardi i Vjetër nr.1; po kështu, kjo formulë e vështirë për t’u mbajtur mend u komunikohet zakonisht ndër biseda edhe të njohurve. Dhe, vetëm nëse dikush do t’i binte ballit me dorë dhe do të shprehej se: “Oh, po, ky është Mërkuri!”. Blami do të pohonte me kokë disi me hezitim, sikur po i nënshtrohej emërtimit jozyrtar, pak si në sëkëlldi, teksa do ta fshihte kënaqësinë e tij. Ose, më drejt, do të lëkundej midis kënaqësisë dhe bezdisjes, sepse nuk i pëlqente të ishte menjëherë i dallueshëm, qoftë edhe prej një detaji kaq të vogël në jetën e tij, që lidhej me qiranë.

Në fakt, arsyeja pse e tërhiqte aq shumë në zemër papafingoja mbi Mërkur mbetej fakti se ajo ishte njëkohësisht e dukshme e po aq edhe një si strehëzë e padukshme. Mund të provojë t’i ngrije sytë nga çdolloj

pike e Sheshit Kryesor apo e bulevardit dhe do të thoshe: “Ja, mu atje jeton Blami”. Por ishte tjetër gjë të arrihe dhe të mund të gjeje çka kërkoje realisht. Para së gjithash, kërkuesi duhej të lejohej të futej në ndërtesë ose t’i përvidhej vëzhgimit të portierit, i cili e mban një sy vigjilent në oborr, duke e kontrolluar qysh nga kuzhina; pastaj do t’i duhej të ngjitej nëpër dhjetëra e dhjetëra shkallë e shkallë, duhet të përshkonte katër të tilla syresh, secila me duzina dyersh dhe me shumë më tepër se duzina banues që jetonin pas tyre, qenie bezdisëse, të cilat endeshin vazhdimisht lart e poshtë dhe, vetëm atëherë mund të arrihej në tarracën majë ndërtesës. Dhe, a do të tentoje atëherë të trokisje në çdo portë dhe të pyesje për të? Por, kujdes ama, se nëse do të shkaktoje sadopak zhurmë dhe do të bije në sy, mund të ndodhte t’ju dëgjonte para se ta gjenit dhe kështu do të mbetej i fshehur përgjithnjë. Madje edhe sikur t’ia gjeje fiks derën e apartamentit. Përkundrajt saj, për shkak se papafingoja devijon papritur nga struktura e kateve të tjera: nis ngushtësia nga gjerësia e mesores së këmbësorëve mbi vetë kalimin, udhëz, e cila mbrohet nga një gardh hekuri, në mënyrë që njerëzit të mos rrëzoheshin poshtë në rrugë, që e bënte të dukej sak si një kuvertë anijeje apo si shëtitore mbi krye të hapësirës së banimit.

Blami e viziton shpesh këtë tip shëtitoreje, vendin që e konsideron si hapësira e lirisë hyjnore, përvjedhur nga apartamenti i tij përmes një mesoreje, përputhur mes dhomës së lavanderisë dhe asaj të tharjes, e cila

është e vështirë për t'u parë dhe mbetet krejtësisht e padiktuar për të huajt. Ndërsa duke lëvizur përgjatë zgripit të ndërtesës, i përshfaqet gjithnjë një pamje që i ngjan asaj të perspektivës që kap syri i zogut mbi drejtkëndëshin e gjerë të Sheshit Kryesor dhe majës së ngushtë në kulm të katedrales, që e dominon atë ose lugajës së gjerë të Bulevardit të Vjetër me varganët e pafundmë të makinave dhe të këmbësorëve, ose të përroskës së rrugës së ngushtë Okruguiq, e vendosur pingul me aksin e bulevardit dhe tavolinave përballë hotelit. Në të vërtetë, është aq shumë i mësuar me ato skena, sa që tërësia e tyre pothuajse nuk ia tërheq fare vëmendjen. Ama ndodh jo rrallë që syri t'i prehet në ndonjë detaj të pazakontë, siç mund të jetë ndonjë re e vetme e errësuar, që pluskon si jastëk, gati të ankorohet majë katedrales, ose poshtë në udhë kur asokohe ndonjë këmbësor apo ajo gruaja e bukur vazhdon të kthehet me përpikëri po në të njëjtin vend të trotuarit. Ai qëndron pranë parmakut, duke mbështetur bërrylat, i etur për të marrë pjesë, për t'iu njëjtësuar turmës. Tashmë është ai kalimtari, që kthehet aty, kurse në gjurmët e veta shndërrohet në vetë atë gruan që pret. Nuk di asgjë, megjithatë, pikërisht për këtë arsye mund t'i përziejë imazhet e fakteve dhe të mundësive. Pamja e një aksidenti që ndodhi dikur përballë asaj pjese të trotuarit, i përcjell në kujtesë imazhin e dy fytyrave të acaruar, që u shfaqën në momentin e takimit. Pasoj zhurma e frenave, e pastaj klithma e tmerrit, që e pushtoi

turmën si frushkullima e një ere. Ajo ishte e martuar, por i shoqi gjendej në burg me akuzë për ngacmim të miturish, ndaj ajo i ka telefonuar një të dashuri të kohëve të vajzërisë duke i kërkuar takim. Nën rrotat e një automobili që ishte ngutur tashmë gjendej ati i Aca Krkljushit, e bash ai vetë ia tregoi Blamit aty në vendin e bulevardit kur ia besoi rrëfimin si i dehur për atë çka ndodhi; këmba e të atit u pre dhe plaku nuk do të mundej më ta mbante dyqanin e lëkurës, kështu që Aca tash e mbrapa duhej ta merrte përsipër të rrinte aty dezurn dhe ta ndërpriste fare punën si edhe zdërhalljet aty-këtu. Sa për admiruesin e vjetër, ai ndoshta po i frikësohej përgjegjësisë, tekefundit ishte beqar (nëse nuk do të ishte i tillë, gruaja e bukur nuk do t'ia kishte kërkuar kurrë takimin): po hamendësonte se mbase ajo dëshironte t'ia zëvendësonte të shoqin jo thjesht në shtrat, por edhe në detyrimet e caktuara familjare. Krkljushi, të themi shëtitësi, nga pozicioni që ka zgjedhur në rrugë, i kujton Blamit sak këtë njeri, në fakt duket se po këqyr terrenin, skicën e të cilës (planimetria, siç thuhet në gjykatë) duhet t'i mbështesë kërkesën për dëmshpërblim që ia përmendi edhe Blamit; ndërsa ai tjetri, i ftuar në takim, e pret gruan ndoshta në një vend të gabuar dhe kohë të papërshtatshme, gabimisht ose nga ndonjë harresë e shkaktuar nga lojërat e kujtesës. Por në fakt, të dy njerëzit e ndodhur atje duke pritur do të shkëmbejnë disa shikime dhe do të hedhin ndonjë fjalë nxitimthi; do të afrohen disi më shumë, do të kuptojnë afërsinë

e tyre me humbjet që pësuan në të njëjtin vend; do të nisin t'i besojnë njëri-tjetrit dhe ai madje do ta ftojë për një pije, ose mbase (sepse mund të jetë dhe në të vërtetë është Krkljushi) t'i sugjerojë t'i çlodhin këmbët duke u ngjitur aty në papafingo, ku banon Blami. Miroslavi pra, është një shok i vjetër shkollë, mik gjithashtu i vëllait të ndjerë Slllobodanit, i cili pati një vdekje tragjike në luftë, duke shtuar se: Blami gjithmonë vjen për të dëgjuar grupin tim, pjesët e mia të reja, ai është pikërisht njeriu që i tregova për aksidentin para dy muajsh, që i kushtoi tim ati këmbën e mua lirinë; ai jeton pikërisht këtu dhe ka një grua të mrekullueshme, mos u shqetësoni, do t'jua prezantoj, ai është shumë mirëkuptues dhe, po ashtu një avokat i mirë, deri-diku apo të paktën ka nuhatje ekonomisti dhe, ndoshta mund t'ju japë disa këshilla për t'ua nxjerrë jashtë burrin, ja, është pikërisht këtu, pikërisht menjëherë pas kinemasë...

Një zile e largët, e pastaj vijon një trokitje në derë. Krkljushi me faqet e tij të lëshuara, hundën e varur, shpatullat e epuara ndjeshëm dhe shprehjen e pangopur, çuditërisht i ngjashëm me të ngratin, vëllain e tij të vdekur Slllobodanin, e shtyn para vetes të huajën e këndshme dhe e paraqet me një buzëqeshje të shpejtë. “A gjendet Miroslavi në shtëpi?”, pyet duke shkelur syrin sikur po bën ndonjë lloj konspiracioni. “Duhet të jetë këtej rrotull”, i përgjigjet Janja, duke iu drejtuar me pamje kureshtare, “po mendoj se po shëtit përreth ndërtesës... ja do ta thërras tani menjëherë”.

“Jo, jo. Mos e shqetësoni, do ta gjejmë vetë, thjesht na thoni ndonjë drejtim se ku mund ta kërkojmë. Kemi ardhur për ca këshilla juridike. Si të them, burri i zonjës...”. Tashmë ata janë sërish jashtë, duke u ngjeshur në mesore pas njëri-tjetrit, sepse Krkljushi do t’i bëjë udhë të shkojë e para, por do gjithashtu t’i tregojë si duhet drejtimin, veçse ajo është pak e rëndë dhe s’po e gjen dot kahun: e frikësuar edhe se era do t’ia shprishë flokët apo do t’ia ngrejë fundin.

Era përplas nga diku një derë, pastaj nuk ndodh asgjë tjetër. Në fakt, të dy janë ende poshtë në trotuar përballë ndërtesës, këtu lart nuk ka njeri përveç Blamit; qiramarrësit e tij i shmangen mesores, pasi është nxehtë në verë dhe fryn erë gjatë gjithë kohës; nëse ndiejnë nevojën për ajër të pastër, ata dalin në tarracën e oborrit, ku mund të dremisin mbi shezlongje, apo ku mund të bisedojnë me një fqinj, të lexojnë gazetatat ose t’i nxjerrin fëmijët të luajnë, vetëm mos ua bezdisin dremitjen e pasdites. Ndaj Blamit i pëlqente mesorja: ai mund të llogariste të ishte i vetëm atje, të paktën derisa dikush të afrohej për ta kërkuar. Sigurisht deri tani pra. Nëse Krkljushi në fakt do të hasej me këtë grua të panjohur, i vendosur për ta gjetur, ose nëse do të kishte me vete urdhër kërkimi për të dhe duhet ta kishte pasur njëherë këtë - duket se ai nuk mund ta imagjinonte të kalonte jetën pa një luftë tjetër, vetë fakti që papafingoja ishte e izoluar e shndërronte atë në një kurth. Ai nuk do të ishte në gjendje të kthehej sërish më pas në tarracë, atje do ta priste një patrullë

e armatosur, që do ta mbante në nishan mesoren; as edhe në banesë nuk do të mund të kthehej më, përveçse përmes një dritareje; ama në rast të ndonjë gjuetie-njerëzish, kërkimi, bastisjeje ose bllokimi, të gjitha dritaret do të kyçeshin, të gjitha perdet do të uleshin, ky është rregulli, madje kjo qysh nga kohërat që s'mbaheshin mend mbase, gjithçka që u mbetej të bënin qiramarrësit ishte të përgjonin struktur pas grilave, me sytë e shqyer duke u dridhur nga tmerri nga ai atje jashtë, teksa një burrë me pistoletë do t'iu shfaqej në hyrje të derës. Kur mund të kthehej? Blamit po i dilte zemra nga vendi, ndaj po i shtrëngonte kangjellat, duke i mbajtur fort, me kokën e përkulur anash, ku gjendej e vetmja rrugëdalje e lirë. Ai nuk do t'i linte ta rrethonin sërish; apo t'i linte ta detyronin të priste urdhrat e tyre dhe t'u bindej pa fjalë, jo, do të hidhej vetë i pari! Ai do ta vërtiste trupin në ajër dhe do të zhytej direkt e me kokë pingul në rrugë, mu sikur të ishte duke u hedhur nga trampolina drejt e mbi ujin e pishinës. Ndjeu një rrymëz të ftohtë ajri që i kaloi nëpër gojë, një zbrazëti që i mbështolli shpatullat, një mungesë mbështetje, e pak nga pak, iu duk se përjetoi edhe zhdukjen e kufijve të hapësirës. Këmbët do t'i tundeshin lirshëm, si të ishte një kukull lecke, ato do t'i zhbëheshin, i gjithë trupi do t'i shformohej, gjaku do t'i plaste nga të gjitha drejtimet, gjithçka do të shkatërrohej, e gjithë bota, rruga drejt të cilës po fluturonte, do niste të shembej.

Duart i dridhen, gishtat i përvëlojnë, shufrat e parmakut i duket se po i futen mu në asht. Ai shtrin duart, i kthen ato, vëren se vragat e kuqe po i zgjerohen ngadalë dhe po humbasin ngjyrën e tyre të ndezur. Ndërkohë, poshtë, njerëzit vazhdojnë të shëtisin trotuareve, të shkojnë nëpër punët e tyre apo të shtrijnë këmbët. Dhe, ai, kalimtari kokëfortë mbetej ende aty, vetëm se gruaja e bukur tashmë ishte zhdukur; ndoshta burri për të cilin po priste tani sapo mbërriti. Ata as nuk ia kanë idenë se çfarë po ndodh brenda Blamit, ç'mund të ndodhë me të; nuk ia kuptojnë fare frikën, terrorin, ndjenjën brenda vetes se patrulla po vjen enkas ta kapë dhe do ta shtyjë mu nga ky parmak. Çfarë është kjo gjendje atëherë? Mos vallë po çmendet? Apo janë çmendur të gjithë veç tij? Por kjo nuk ka rëndësi, sepse i vetmi që bie në sy, atëherë është një përbindësh, një fanatik, një lajthitje, i pjekur për t'u çarë dhe për t'ia lexuar mendimet, për t'u futur brenda një kafazi dhe pastaj të arrijë të ekspozohet porse në një si biçim hapësire antropologjike dhe jo në kopshtin zoologjik, i ekspozuar krejt i zhveshur, më mirë të shihet dhe të futet nëpër hekura derisa të prodhojë ulërimat dhe britmat jo të zakonshme, që do të priten prej tij. Kanatat pas tij trokëllinë, dikush po ulte grilat nga një prej dritareve të papafingos. Zhurma nisi nga e majta, që do të thotë se i takon grilës së pensionistes me probleme të mushkëritë apo dikush syresh nga apartamenti i saj. Ai nuk e kthen fare kokën. I frikësohet skenës që do t'i ofronte personit, i

cili përgjon nga dritarja: një kokë e anuar mbi një trup ende përballë rrugës, prej humnerës, me një fytyrë ku shquhen shenjat e një imagjinate tepër aktive. Një fanepsje kaq e vërtetë për Blamin sa çdo gjë tjetër, e cila po i ndodh pas shpine. Po, ai e pranon veten disi me siklet, por edhe me një si farë zemërimi. Ajo botë, kaq e besueshme, atje, është pjesë e ndjekjes, edhe pse nuk është më në shërbim të saj - atje tej është Janja që mbase është duke qepur, ndoshta vogëlushja po bën detyrat e shtëpisë. Kur pasazhet zotërohen, një sfond i tillë bëhet katastrofik; në përgjithësi, çdo sfond është fatal nëse është i gjallë, nëse është i lidhur me zemrën që të rreh, me nervat e tua, nëse krijon një bashkim me ty. Atëherë plumbat s'të godasin vetëm ty, ashtu si ti nuk mund të hidhesh në tokë pa mbulim. Nuk ka më strehë kur të pushton dashuria dhe, të gjurmon përndjekja: është diçka pa dalje, paradhoma ku shkon drejt altarit të flijimit, drejt të cilit po lëviz, i shtyrë, pa kthim, e ashtu i përkulur.

Koka vazhdon duke iu varur poshtë, duke pritur të shohë nëse batërdia do të rritet më tej në thirrje, një shfrim habie, madje një urdhër, që është vdekjeprurës. Por s'dëgjon asgjë më shumë. Ashtu si askush nuk po e këqyr. Blami kthehet ngadalë dhe, duke ia mbajtur sytë e ngulur udhës së asfaltit niset drejt mesores, se nëse ndodh që mund të rrëshqasë kështu pa pengesa, ai do ta shmangë apartamentin, shtëpinë, kurthin dhe do t'i drejtojë hapat pa u ndier në drejtim të kundërt, kah shkallëve. Do t'ia mbathë poshtë shkallëve drejt

lirisë. Ndoshta kështu mund të rrokë edhe një pamje të fundit të kalimtarit të panjohur apo të gruas së bukur.

II

Natyrisht, nuk i gjen më, janë zhdukur ndokund në pjesën e brendshme, të gëlltitur tashmë nga turma, apo ndoshta janë ende aty në të njëjtin trotuar, mbase edhe s'mund të njihen më. Njerëzit duken ndryshe kur je në të njëjtin nivel me ta, u ndryshojnë proporcionet e trupave, lidhja mes pjesëve të tyre. Zgjatjet paksa të dukshme: balli, hunda, gjoksi, shpatullat u zvogëlohen ndërsa gjymtyrët, thuajse të padukshme nga lart, dalin më të zmadhuara. Ndryshojnë edhe ngjyrat: të flokëve, të syve, ngjyra e lëkurës, shfaqen kushte të reja të peshës, efektet e gjurmëve të dikurshme, rrobat tashmë u bien ndryshe, këndi i ri thekson disa rrudha dhe hije ndërsa zbut të tjerat. Kur e këqyr nga lart ecjen e një personi, ajo të duket e lehtë dhe e butë; por, në nivelin e syve, është më e rëndë, përfshin përpjekjen me një rën këmbë gjithmonë që mëton ta shtypë më shumë tokën. Nga toka është e qartë se njerëzit nuk shtyhen nga një forcë e panjohur, nuk tërhiqen nga ndonjë fije transparente apo ndonjë dorë e fshehur; lëvizin duke kontraktuar muskujt e këmbëve dhe duke zhvendosur peshën e trupave të tyre në drejtimin

që dëshirojnë të shkojnë, lidhja e tyre me tokën është e qartë, vërtet, ata largohen prej aty, qëndrojnë në këmbë, por ajo mbetet pjesë e tyre dhe tek ajo do të kthehen sërish. Edhe ai, gjithashtu, këtu ngjall kuriozitetin edhe me larminë e formave: qoftë si të ishte fëmijë, vajzë apo plak: por nga toka përparimi i fëmijës, vajzës dhe plakut mund të përshkruhen nga fillimi në fund me misteret, që mbeten të zgjidhshme.

Njeriu që shfaqet përpara se Blami të zbulojë misterin është një agjent pronash të patundshme me emrin Leon Funkenshtajn. Blami e vëzhgon ndërsa po qëndron në cep përballë Mërkurit, duke këqyrur anën më të largët të sheshit prej katedrales deri në kinemanë “Avala”. E gjithë ajo hapësirë është e mbushur me makina të parkuara, sepse fillimi i rrugës që hapet pas “Avalës”, ajo që dikur njihej si rruga e “Hebrenjve” tani është kufizuar në skajin tjetër nga “Bulevardi i Ri” dhe kështu është krejt e pezulluar për trafikun: Kjo është arsyeja pse Blami dhe shumë bjerraditës kot si puna e tij e konsiderojnë si destinacionin e tyre të preferuar.

Tani hapat e tij frenojnë për shkak të Funkenshtajnit. Nuk ka më arsye ta shmangë, paçka se doli për shëtitje të kalonte pak kohë me veten: apo t’i shmangej disi përndjekjes dhe, kjo për të do të thotë një sulm i të njohurit, i përvojës ku për fat të keq, bie edhe ky ndërmjetësi i vjetër. Nuk është i sigurt nëse Funkenshtajni do të arrijë ta njohë; Blami ishte fare

fëmijë në kohën kur Funkenshtajni pat ardhur dikur në shtëpi. Por në të njëjtën kohë, vitet e fundit, i ka ofruar Funkenshtajnit shumë mundësi t'i rifreskohet kujtesa, t'i thërrasë kujtimeve duke i dhënë ndonjë buzëqeshje të matur, me ndonjë përshëndetje me kokë apo ndonjë përshëndetje më të zëshme, kur sytë e tyre janë hasur ballë për ballë në kalimin e ngushtë mbi ndonjë trotuar. Por këtë herë ka shumë hapësirë, i gjithë sheshi i bën me shenjë Blamit drejt ish-rrugës së “Hebrenjve”, kurse Funkenshtajni gjendet në skajin më të largët të sheshit, duke u përkulur mbi radiatorin e një automobili, me kokën e tij tullace aq poshtë sa duket sikur po e nuhat dhe jo sikur të jetë duke e kontrolluar.

Por, siç ndodh shpesh, kur dëshiron të shmangesh nga dikush, Blami i drejton hapat drejt Funkenshtajnit, duke e përshkuar sheshin në një mënyrë të tillë që të jetë sa më i dukshëm. Në të njëjtën kohë, trajektoren e tij sulmuese e justifikon me njëfarë kurioziteti: ai befas interesohet, me rastin e asaj dredhie të çuditshme rreth makinës, ku ta dish mbase Funkenshtajni mund ta kishte ndryshuar profesionin e tij, gjë që ngjan mjaft e mundshme, duke qenë se ndërtesat me qira janë subvencionuar prej kohësh dhe shitja dhe blerja është zvogëluar, sipas të gjitha gjasave, për shtëpi fare të thjeshta banimi, pra të lira. Kjo do të ishte krejtësisht e kuptueshme, duke pasur parasysh se të gjitha pronat me qira janë shtetëzuar prej kohësh, gjë që lë ende në treg vetëm banesa të vogla dhe për rrjedhojë të

lira, mu si ajo shtëpia që zotëronin Blamët në sheshin “Vojvoda Shupljikac”, sak atë që Funkenshtajni e kishte shitur për Vilimin, të atin e Blamit. Ose, nëse e kishte marrë, nuk pati kohë t’i shpenzonte të gjitha, ndaj edhe ai ra pré e grabitjes.

E shqetëson mendimi se përfundimisht do t’i duhet të flasë me Funkenshtajnin, ta pyesë për të dhënat e shitjes së shtëpisë për të shuar dyshimet e mbledhura. E ndien se e ka shtyrë bisedën për një kohë të gjatë (ashtu si edhe dyshimet), por kjo është e mjaftueshme ta kthejë kokën në drejtim të Funkenshtajnit dhe të habitet kur e kupton se njësoj, edhe ai është duke kërkuar të hedhë vështrimin drejt tij. Nis e ngadalëson disi hapin, por mezi mund ta besojë paçka se nuk mund të ketë asnjë dyshim: nga fytyra e gjerë dhe rozë e plakut, ende ulur mbi radiatorin e “Fiat”-it, një palë sy të vegjël por të mprehtë kaf po e shikojnë ngultas Blamin poshtë vetullave gri të harlisura dhe një balli plot shkëlqim.

Ai ndalon, e pas kësaj Funkenshtajni drejton trupin. Pozicioni i ri nuk e ndryshon shumë pozicionin me makinën, pasi është shumë i shkurtër për këtë, veçse përshfaq shijen e guximshme në rrobat që mban: një këmishë të bardhë me jakë tip apashi mbi një palë pantallona tip sateni të verdhë, tani ai, bashkë me atë draperinë e një veshjeje rinore, që i varet shkujdesshëm, vihet në lëvizje dhe duket i gjallë, e çuditërisht aktiv për trupin e shkurtër rrondokop, madje del mbi kapakun e motorit të makinës dhe shpërfaqet para Blamit.

- Mirëdita, z. Funkenshtajn, - i thotë Blami disi me habi.

- Mirëdita, mirëdita, - ia kthen ndërmjetësuesi me përzemërsi, por pa përdorur emrin e Blamit, gjë që faktin se supozimi i tij që Funkenshtajni nuk do të ishte në gjendje ta njihte, rezultoi i saktë. I zgjat Blamit dorën e fortë dhe mishtore; e shtrin atë, megjithëse rastësisht, disi anash, është duke rrëmuar me kujdes mbi fytyrën e Blamit drejt e në sytë e tij të vegjël e të zbehtë.

- Çfarë ju ka sjellë këtu? - e pyet i përmbajtur, me sytë e vegjël vezullues që i kthen shpejt nga bashkëbiseduesi, ama duke këqyrur vazhdimisht diçka mbi supin e Blamit.

- E, ja po shëtis, - pohon Blami, i cili ndihet disi parehat prej mungesës së përqendrimit të Funkenshtajnit, gjë që e detyron të vazhdojë bisedën.

- Megjithëse meqë tani ju kam këtu, mendova t'ju pyes për një shtëpi, që shitët pak kohë më parë. Më thoni, a merreni ende me prona të paluajtshme?

- Po, po, vazhdoj të merrem. Po, natyrisht që vazhdoj. - Funkenshtajni i hedh një vështrimin të shpejtë dhe shpues, por menjëherë shikon përsëri mbi supin e Blamit. - Mos keni vallë diçka për të shitur?

- S'më ka mbetur asgjë tashmë, - ia pret Blami duke ngritur supet. Papritmas ndihet i fyer nga indiferenca e Funkenshtajnit dhe vendos t'i japë fund bashkëbisedimit, që nuk është se po merr jetë gjithsesi. - Më duket se tani po ju interesojnë më shumë makinat.

- Jo, vetëm njëra. - Sërish Funkenshtajni e ngre vështrimin dhe e çon te Blami, këtë herë në mënyrë pyetëse, sikur të ishte duke e pyetur nëse atij duhej t'i besohej apo jo. - Gjithsesi, s'është imja, po e kontrolloj, është e një miku.

Blami kthehet i hutuar dhe, arrin të këqyrë një makinë të madhe jeshile, e parkuar veçmas mu në mes të sheshit. Në të njëjtin çast, Funkenshtajni e kap nga krahu dhe e rrotullon t'ia tërheqë vështrimin. - Mos u ktheni më herë tjetër! - i pëshpërit, duke ngritur vetullën e thinjur si shkurre dhe duke shtrënguar buzët rozë, të rrudhura, ku shquhen qoshkat e shkumëzuara nga pështyma. - Nuk dua të më vish më këtu!

Blami e kalon peshën i shqetësuar nga njëra këmba te këmba tjetër, duke kuptuar se Funkenshtajni po e përdor kapakun e makinës si mburojë, nga ai, që i ka zënë pamjen "FIAT"-it të pluhurosur ngjyrë gri.

- Pa shiko! Shiko! - bërtiti befas me gëzimin në fytyrë, duke mos e fshehur ngazëllimin. Hidhet lart e poshtë, përkulet duke vështruar nga pas Blamit si fëmija që luan. - E po, ja e shikon? Tani, po hipin në autobus!

Atëherë, papritmas u lehtësua, e drejtoi kurrizin dhe shpjegoi në një formë disi të pahijshme.

- Këtë ma kërkoi si favor një mik i vjetër, si ta them më shkoqur: partner biznesi. Ai ka ikur për pak nga qyteti, ndërsa unë po kujdesem për t'i ruajtur të shoqen. E di që ajo është bërë gati për diçka, që kur ia pashë makinën në shesh. Ç'të them, ja u largua me një burrë me atë autobusin. Me siguri po shkon drejt shtëpisë së tij.

Blami ka mundësi të na tregojë, nga drejtimi i vështrimit të ngulët të Funkenshtajnit, sesi ai është duke ndjekur autobusin me sy (apo mbase me mendje), që ndërkohë kalon pas monumentit, drejtohet kah Danubit dhe po i afrohet pjesës së qytetit, mbushur me banesat e reja të banimit për zyrtarët e sapoardhur; e kështu ndjek edhe burrin e ri ezmer, veshur bukur dhe gruan e gjatë bionde përkrah me kofshët e saj të forta, të tendosura brenda fundit blu. Në të njëjtën kohë dyshon nëse arsyeja e imagjinatës mund të jetë vërtet një botë kaq e re, pasi “shoku i vjetër” i Funkenshtajnit, nëse është qoftë moshatar me të, duhet të jetë aty drejt të shtatëdhjetave. Por as nuk duket i bindur se e gjitha s’është thjesht sajese: nis e shikon me dyshim ndërmjetësin.

Por Funkenshtajni ndahet pa folur prej tij e është në udhë drejt makinës jeshile në mes të sheshit, duke e anashkaluar Blamin me këmbët e tij të ngjeshura, sikur të ishte thjesht objekt. Blami po ashtu kthehet dhe sigurohet që autobusi, nëse vërtet ka qenë pak më parë, të mos qëndrojë më në ndalesën pas monumentit.

- Ku thoni se ishte shtëpia juaj?

Funkenshtajni është kthyer sërish dhe afrohet nga Blami pasi i hedh një sy makinës.

- Të thashë se nuk e kam më, - ia kthen i mërzhitur Blami. - I takonte të ndjerit tim ati në sheshin “Vojvoda Shupljikac”, numri 7. E shiti përmes ndërmjetësisimit tuaj, diku nga fillimi i luftës. Nuk e di nëse e mbani mend.

- Sheshi “Vojvoda Shupljikac”... “Vojvoda Shupljikac”... - mërmërit Funkenshtajni me vete, duke ulur kokën dhe duke shtypur hundën me gishtin e trashë tregues. Papritmas, shikon duke u kthyer. - A mos je vallë Blami?

- Po. Kështu që po kujtoheni.

- Diçka po kujtoj, - ia pret jo shumë i qartë. - E po, çfarë?

- Kam dashur të di shpesh nëse arriti t’i marrë im atë paratë për shtëpinë, dua të them të gjithë shumën e shitjes. Njeriu që e bleu shtëpinë ishte njëfarë rrobaqepësi. Më duket se emri i tij ishte Hajdukoviç. Por më pas ky e shiti te dikush tjetër..

Funkenshtajni nuk e lë t’ia mbarojë paraqitjen.

- Nëse shtëpia do të ishte shitur përmes meje, - i thotë shkurtimisht, ndërkohë që duart i vendos mbi gjoks duke tërhequr pak këmishën e bardhë, - atëherë duhet të jeni i sigurt se janë paguar të gjitha paratë kokërr më kokërr. - E përshëndet me një tundje të kursyer koke dhe i zgjat dorën Blamit: - Mirupafshim! - largohet, duke ecur me shpejtësi me këmbët e shkurtra, me hapa të gjatë drejt monumentit.

Sheshi “Vojvoda Shupljikac” nuk gjendet shumë larg qendrës së qytetit, duket prej labirintit të rrugës së vjetër të ngushtë, e cila tani shtrihet në kthesën e gjerë të Bulevardit të Ri. Shtëpitë rreth sheshit krijojnë formë ovale, në mes të së cilës, shtrihet një park i lënë pas dore, rrethuar me gardh metalik, hekurat

e të cilit përdridhen shpesh nga duart dhe këmbët e njerëzve të dhunshëm; toka në park ka qenë kaq e lënë pas dore, saqë gati asgjë nuk rritet atje; ato pak stola atypari janë pa mbështetëse, teksa ulëset e tyre të brazda plot me inicialet e të dashuruarve, shiu i ka zgjeruar në plagë të palexueshme. Vetëm pemët që rrethojnë gardhin kanë qenë në gjendje t'i rezistojnë shkatërrimit; janë të larta dhe të vjetra dhe kurorat e tyre me gjethe ngrihen mbi shesh si një ombrellë e stërmadhe jeshile.

Blami, gjithashtu, kontribuoi në shkatërrimin e kësaj oaze: Kur ishin fëmijë, në drekë kur ktheheshin nga shkolla në drejtim të shtëpisë ai dhe Çutura kishin qejf të kërcenin mbi gardh, duke shkelur barin, duke iu ngjitur pemëve apo duke ngrënë ide.

Përpara se të shoqërohej me Çaturën, as ia kishte idenë se të tilla gjëra mund të bëheshin apo edhe mund t'i jepnin dikujt ndonjë lloj kënaqësie. Ai ishte ngjitur më parë, por vetëm mbi plloçat e shtëpisë, apo mbi pusin me trumbë, ku kujtesa e vetme e natyrës ishte shtrati i luleve që përshkonte murin e lartë e të zhveshur, ndarë befas prej apartamentit të veçantë, marrë me qira nga një e ve e quajtur Jelisaveta Çokonaj¹. Këto përbënin të gjitha çapkënllëqet e fëmijërisë së tij: si edhe rrëshqitja dikur nga një

¹ Erzebet Csokonay (emri origjinal në hungarisht). Të gjitha shënimet në tekst janë të përkthyesit.

trumbë drejt e mbi një tullë të fortë, apo edhe lufta me motrën e vogël Estera, që do të shndërrohej në qortim nga e ëma ose ngandonjëherë me Puba Shmuk, kur nëna e Pubës erdhi për t'i vizituar Blamët dhe e sollti atë me vete për të luajtur. Shtëpia i ngjante një kështjelle nën një rrethim të padukshëm, e vizitonin vetëm të afërm, miq të familjes apo riparues edhe këta nëse i kërkonin, veçse asnjë të huaji, përveç të themi ndonjë lypësi atypari; miqtë e dinin se aty i prisnin gjithnjë gatime të shijshme, pasta të mrekullueshme shtëpie, fruta të freskëta të sapoblera në treg dhe pastërtia që ndriste kudo. Sa herë që dilte nga shtëpia, duke u kapur dorë për dore me Esterën, e veshur me të bardha ose blu si ai dhe, duke ecur përpara prindërve, të cilët vazhdonin t'i bezdisnin të mos ecnin nëpër trotuarin me baltë, Blami shikonte nga pragu i portës parkun oval, por nuk arriti ta pyeste Çaturën kurrë për emrat e pemëve, që i binin në sy teksa përkundeshin gjithë hijeshi nga fladi. Për Blamin, një pemë ishte thjesht dru, diçka e madhe dhe e fortë, edhe pse elastike, e gjallë, në kontrast të gëzuar jo vetëm me suvanë gri të rrugës, por edhe me karrocat që vinin në shtëpi me drurin e papërpunuar dhe të thatë në fund të çdo vere, e që pastaj gatiteshin për t'u prerë në copa të shfrytëzueshme nga druvarët mes gumëzhitjes së sharrave dhe erës së ashklave dhe të djersës - e ndërsa ai ishte i vetëdijshëm se “druri i ahut” dhe “druri i lisit” e kishin origjinën nga pemët, ato pemë rriteshin në pyje të largëta të panjohura që ai

s'i kishte parë kurrë dhe pastaj priteshin nga druvarët që të transportoheshin më vonë në qytet me vagonë të hapur mallrash.

Pastaj një ditë, Çutura i sugjeroi:

- Hajde, po sikur të hamë pak hide! - dhe kërceu i pari mbi një thupër të përkulur midis dy shtyllave të pjerrëta hekuri dhe humbi diku mes shkurreve. Kishte ardhur mesdita dhe bënte shumë nxehtë, dielli po i flakte shtizat e arta përmes gjetheve drejt e mbi flokët e gjatë dhe fytyrën plot puçrra të Çaturës. Blami e ndoqi me kujdes nga pas, por njëra anë e pantallonave i ngeci te thupra. Duke parë se ku do ta linte çantën e shpinës dhe të lironte duart, dalloi librat e Çaturës që u shpërndanë mbi tokën e zhuritur, dihej se Çutura nuk mbante fare çantë. Mirëpo, duke mos i rezistuar këtij zakoni, e vendosi çantën më larg, në hije, pranë një trungu peme dhe vetëm më pas filloi të kërkonte shokun. Atë çast, Çutura gjendej i varur në degën më të ulët të pemës, këmisha e tij e hapur na kish zbuluar barkun me muskujt e gdhendur rreth kërthizës, kur sakaq u tund, mbështeti këmbët në degët më sipër dhe në vetëm një moment u vërvit lart.

- Kape! - i bërtiti, duke i flakur Blamit tri kokrra me ngjyrë të kuqe të thellë, të lidhura ende me kërcell të ngurtë. Blami i kapi, por nuk po dinte se çfarë mund të bënte më pas, derisa hodhi sytë sipër dhe pa Çaturën që po këpuste edhe më shumë syresh dhe i hidhte direkt në gojë, duke i përtypur e më pas i flakte bërthamat e vogla përmes dhëmbëve të tij. Edhe Blami

u përpoq ta kapërdinte njëërën syresh. Në momentin që hëngri kokrrat e kuqërremta, një ëmbëlsi e ngrohtë dhe me tul i përmyti gjuhën dhe ia mbuloi krejt qiellzën e gojës. Ishte sikur s'kishte provuar kurrë një gjë të tillë: ishte si përtylja e njollave të diellit ose e një gjetheje me pluhur, makar ndryshkut në gardhin e hekurt; ishte si të haje tokë të papërpunuar, të thatë dhe të brishtë, pasi kishte gërmuar në të. Ai vazhdoi të priste fruta nga Çutura, që vazhdonte t'i hidhte disa syresh direkt e në gojë, duke i përtypur dhe duke i pështyrë ngado bërthamat, duke vazhduar e futur gjithnjë e më shumë në gojë, derisa Çutura u lodh dhe u hodh në tokë, i zhdërvjellët si mace.

III

Sikur Çutura të ishte ende gjallë, ka të ngjarë që mbrëmja e mrekullueshme e verës do ta kishte grishur edhe atë të afrohej drejt sheshit, duke e bërë kështu dëshmitar të ballafaqimit të Blamit me Funkenshtajnin. Si dëshmitar i mirë perceptues dhe me iniciativë, ashtu si kishte qenë gjithmonë, ka të ngjarë të ishte afruar aty thjesht nga ku mund të arrinte e të dëgjonte dhe, pas largimit të papritur të tyre, do ta shtynte Blamin në një bisedë, që mund të kishte shkuar pak a shumë kështu:

- Kush ishte ai njeri?

- Ai? Harroje! Njëfarë Funkenshtajn, agjent pronash të patundshme. Apo mbase ish-agjent pasurish të patundshme.

- Më duket se po më flet për shtëpinë, ku jetoje dikur?

- Po, në fakt, ia përmenda, sapo u takuam.

- Dhe?

- E ndoshta edhe e dëgjove. E pyeta robin nëse im atë i kishte marrë të gjitha paratë e shitjes së shtëpisë. Ai tha se me siguri do t'i kishte marrë.

- Nga ku del qartë se s'ke parë as edhe një qindarkë të vetme nga ato para.

- Ashtu është.

-E po mirë, cili ishte pra? Apo ta themi më qartë: kush i përblau paratë?

- As ia kam idenë.

- E, gjithashtu, duket se as nuk po orvatesh për ta zbuluar.

- Nuk mundem. E nuk do të guxoja, nëse vërtet do të dish. S'kam guxuar t'u kërkoj shpirtrave të vdekur të prindërve të më thoshin ndonjë gjë për paratë e tyre. Isha i tmerruar.

- Po, në atë moment do të ketë qenë, me të vërtetë, e tmerrshme. Dhe, është e kuptueshme. Po pse nuk e bërë më vonë të paktën? A je përpjekur të dish ndonjëherë se kush i kishte plaçkitur?

- E kush vallë mund ta dinte këtë?

- Si?! Po më duket se kjo është shumë më e thjeshtë! Dua të them, se do të kish qenë gjithnjë një gjë e qartë, ashtu si është edhe sot, që do t'i ketë plaçkitur ndonjë nga të brendshmit, para së gjithash ndonjë nga qiraxhinjtë. Kujto për shembull atë hungarezin, që muajt e fundit u zhvendos me atë qiraxheshën në kopshtin tënd? Si e kish emrin?

- Koçish.

- Po tamam, Koçish. Ia shikoja shpesh atë shenjën e Kryqit me Shigjetë¹, fiksuar në thilenë e xhaketes. Ai sigurisht duket tipi, që nuk do të mund të dështonte të hynte në një apartament të braktisur, pasi t'i çojë pleqtë në botën tjetër.

- Si mund të thuash një gjë të tillë!

- E them sepse është absolutisht e qartë: se ishte ai që i hoqi qafe. A nuk gjendej atje ditën e bastisjes?! Xhandarët do ta kenë pyetur me patjetër për prindërit e tu. Ata i përdorin njerëzit e tillë gjatë asaj kohe, i kërkojnë informatorët, sigurisht nuk mund ta humbin një të tillë.

- Ky është thjesht vetëm hamendësim.

- Po, nëse mendon se është hamendësim, edhe pse kjo duket krejt logjike, duhet të paktën të hetoje. Po ti nuk ke bërë as edhe një gjë të vetme.

- Jo.

- Çfarë do të thotë tamam? Që i le ata kriminelë t'i hiqnin qafe prindërit dhe t'ua grabisnin gjithçka që kishin. Ku janë tani, a e di të paktën?

- Cilët?

- Po ata, pra. Ai Koçishi dhe e dashura e vet?

- S'ia kam fare idenë.

¹ Emblema 'Nyilaskereszt' ("Kryqi me shigjeta") konsiderohet një simbol i fiseve Maxhare të cilat, nga fundi i shekullit të 9-të, pushtuan dhe u vendosën përfundimisht në atë tokë, që pas shekujsh më vonë u formua Hungaria. Ikonografia e partisë 'Nyilaskeresztes', që e përdor këtë simbol, është e frymëzuar qartë nga ajo e nazistëve.

- Çudi të mos e dish këtë? A qëndruan sërish në shtëpinë tuaj?

- Po, mendoj ndoshta edhe për pak kohë. Por dëgjova pastaj se lëvizën drejt Budapestit.

- Ç'do të thuash me ndoshta? Po a u interesove tamam? Dhe, nuk ke pasur sadopak hamendësime me veten?!

- Mos flit budallallëqe. Më duhet të kthehem në shtëpinë e prindërve dhe të mbledh atë çka ka mbetur prej tyre. Ishte qiraxhiu i ri që më tha se Koçish dhe ajo gruaja u zhvendosën drejt Budapestit.

- Por, ti ama nuk i gjete paratë.

- Jo.

- Sigurisht që jo. Ato para ua rregulluan jetën dhe me anë të tyre ia mbathën. Ata nuk do të kishin mundësi të zhvendoseshin kurrë pa to. Por nëse nuk do të kishte qenë për paratë dhe fajin që patën për vdekjen e prindërve, ata s'kishin fare arsye pse të lëviznin. Vallë, s'e ke të qartë as këtë? Ishin të frikësuar se një ditë mund të përgjigjeshin për atë që bënë, ndaj zgjodhën të largoheshin nga qyteti. Nuk po e kuptonin se kishin të bënin me një kundërshtar si ti, që nuk do të guxonte të ngrinte as gishtin për vdekjen e prindërve. Ata do të mund të qëndronin lehtë, të ishte vetëm për ty. Pos të gjithave, ata edhe mund të ishin rikthyer. Pasi panë që askush nuk iu vu pas, askush s'bëri ndonjë denoncim dhe tashmë pluhuri i kohës kishte davaritur çdo gjë. Në fakt, jam i sigurt se janë rikthyer. Gjithsesi, sa mund të kishin

përlarë? Dhjetë mijë pengo¹? Pesëmbëdhjetë mijë? Kaq nuk janë asgjë për një bastard të tillë si Koçishi, që s'arrinte t'i ruante dot paratë. Ata dinin vetëm t'i numëronin. Dhe, kur paratë u mbaruan dhe dashuria nuk zgjati, heronjtë tanë u kthyen sërish në folenë e shtëpisë. Sepse e kam fare të qartë se ata lanë dikë këtu, kur shkuan në "muajin e mjaltit".

- Nuk mendoj se ajo kishte ndokënd. Vetëm një vajzë dhe jam i sigurt se atë e mori me vete. Por Koçishi me siguri ishte i martuar, me aq sa kujtoj, madje kish edhe fëmijë.

- Atëherë, problemi me ta është i thjeshtë. Ajo çka mund të bësh është t'i vihesh pas familjes dhe t'i gjesh e të marrësh vesh se ku është babai.

- Jo, nuk është kaq e thjeshtë. Unë s'i kam njohur kurrë. Nuk e di as se ku jetojnë.

- Ekziston Byroja e Punëve të Brendshme, e cila merret me të gjitha llojet e regjistrimeve. A mund të dihet si e kishte emrin e pagëzimit ai Koçishi i famshëm?

- Lajosh. E thërrisnin Lajosh Koçishi.

- Kështu, pra. E po, nuk do të jetë shumë e vështirë për të kontrolluar, pasi nuk janë kaq shumë Lajosh Koçishë në Novi Sad. A je dakord me këtë?

- Me çfarë?

¹ Pengo ishte monedha e Hungarisë, e cila doli në qarkullim më 1 janar 1927 deri në kohën kur zëvendësoi koronën më 31 korrik të vitit 1946, kohë kur u zëvendësua nga forinta. "Pengu" përbëhej nga 100 filler.

- A je dakord, që ta marr unë përsipër këtë muhabet. Nuk kam fare keqardhje ndaj këtij njeriu, siç ke ti. Përveç kësaj dhe në ndryshim me ty, e konsideroj veten të detyruar të hakmerrem për krimin. Vrasësve të prindërve të mi kish se kush t'u merrte hak: vëllezërit e mi. Por ai Koçishi, mbeti dhe jam fare i sigurt për këtë, i padënuar. Ndiej se është detyra ime të bëj diçka për këtë, qoftë edhe për shkak të Esterës, në kujtim të saj.

- Nuk e di. S'më duket se është gjëja e duhur.

- Nuk do ta dimë, po nuk u përpoqëm. Por nuk besoj se je kundër që të nis të interesohem pak përreth.

- Kuptohet, që jo.

- Do ta mbaj fjalën. Dhe, ki besim se shpejt do të kem se çfarë të të them.

Por Çutura s'është më mes të gjallëve, ndërsa Blami e lë sheshin për të shkuar në rrugën e "Hebrenjve", ashtu i vetëm, i pandikuar nga askush, me mendimet e tij vetjake, i zhytur në përfytyrime. Ndërsa ecën përgjatë vitrinave lëbyrëse të dyqaneve, rreshtuar në të dyja anët e rrugës, ndien një lloj drithërimë keqardhjeje që Funkenshtajni nuk e la të kthehej dhe të shikonte çiftin kurorëshkelës të kapur gafil. Sërisht i shfaqet burri zeshkan i veshur këndshëm dhe gruaja e gjatë bionde, me fundin e shtrënguar pas kofshëve, mënyra sesi janë duke u përqafuar dhe kupton se është një përqafim lamtumire, kujtimi i një përqafimi

që ai vetë ka dëshmuar kohë të shkuara dhe që iu duk si lamtumirë personale.

E përjeton edhe një herë kështu. Kjo është një ndjenjë e hidhur humbjeje dhe tërheqjeje, por edhe çlirimi, që përkon me kujtimet e shkaktuara nga pamja e dyqaneve, të cilat i prek me një shikim të vetëm. Realiteti është se dyqanet e dikurshme janë rimodeluar, hyrjet e tyre janë zgjeruar, druri i plasarit i kornizave të dritareve është zëvendësuar me materiale metali të shndritshme, ka plot mallra në vitrina, një vend dikur i ish-mbipopullimit agresiv, të shtruar me mjeshtëri dhe qartësi, emrat ekzotikë të pronarëve në tabelat janë zëvendësuar me termat e përhershëm të përgjithshëm, ndërkohë që atypari lëvizte zakonisht një staf i tërë mbushur kryesisht nga të rinj me pamje zyrtare dhe indiferente. E gjitha duket mjaft qetësuese. Do të thotë një hap në drejtim të humbjes së personalitetit. E çliron disi nga brenga që ndiente dikur, kur përballej me fytyrat e errëta, të tensionuara, sytë e zgurdulluar, zërat e pacipë që lavdëronin zhurmshëm mallrat duke e poshtëruar atë me kujtimet e prejardhjes së tij. Tani dyqanet, të pastruara nga e kaluara e tyre, janë edhe për të vende blerjesh dhe shitjesh të drejtpërdrejta. Do të doja këtë dhe atë! Sa kushton ajo? Unë do ta marr ose jo s'po e marr. Megjithatë, në të njëjtën kohë, s'mund të mos vuajë për botën sipërmarrëse, sak asaj shtrese, të cilës, sado me ngurrim dhe rezistencë, i përkiste.

Përfaqimi i lamtumirës ishte i ngjashëm, por në njëfarë mënyre, është e kundërta e skenës së

asaj lamtumirës, që kundroi aksidentalisht nga një tramvaj shumë vite më parë. Rastësisht, sepse atë ditë Ferenci, shefi i Agjencisë së udhëtimit “Uti” ku sapo ishte punësuar, i kërkoi për herë të parë dhe të fundit ta linte tavolinën dhe të dorëzonte shpejt një pako me dokumente në doganë. Ishte mëngjes i ftohtë nëntori në vitin e parë të luftës dhe, Blami po zhytej në sediljen me mbështetësen prej druri pranë dritares në qoshk të tramvajit. Ndërsa tramvaji përshkoi rrugën duke u lëkundur drejt zyrës doganore, ai po vështronte aty prej qoshes. Rrugët ishin pothuajse të zbrazëta, ngutja e mëngjesit kish mbaruar dhe dyqanet kishin nisur punën, por ajo çka s’i kapi syri teksa shikonte nga dritarja, ishte një plak i përgjumur, një amvisë që nxitonte në shtëpi vonë nga tregu me çantën prej rrjete, një postier dhe një shegert që mbartte një shportë mbi shpinë. Dhe, atëherë mu përpara zyrës së doganës ku disa shtëpi të vogla grumbulloheshin së bashku, tramvaji kaloi fare pranë një çifti të përqafuar: një burri ezmer veshur me pardesy gri dhe një grua bionde e cila mbante veshur kostum cohe blu. Po qëndronin pranë bordurës së trotuarit, midis shinave të tramvajit dhe shtëpive, kaq të lirë, pa askënd t’i shqetësonte duke ua ngulur kureshtar sytë, mbështetur plot lumturi kundrejt njëri-tjetrit, ai me dorën e nxirë, mbështetur në kofshën e saj të tendosur, ajo, tejet e gjatë, me krahun e hedhur mbi supin e tij dhe, me flokët biondë që i derdheshin prej kokës e ia mbulonin fytyrën. Megjithatë, Blami nuk e pati problem ta diktonte të

shoqen, Janjën me Predrag Popadiqin. Mendimi se ajo po e mashtronte me atë burrë ishte si ajo thika që tash po i ngulej direkt e në bark, kjo ndjesi ia mori frymën, për pak i ra të fikët, megjithatë nuk bërtiti, as nuk u hodh të dilte me vrap nga tramvaji; qëndroi i vendosur, mbështetur në sediljen e drurit, duke kthyer kokën për t'i ndjekur, ndërsa tramvaji po u kalonte ndanë duke u tundur. Pamja e përqaqimit të tyre në rrugën e shkretë e mbushi, pavarësisht tmerrit, me një lloj admirimi ngurrues, e thujse u kthye në dashuri. Ishte përqaqimi i tyre i fundit para largimit, mund ta dallonte nga mënyra se si qëndronin aty, ashtu si edhe nga qetësia, lehtësia e lumtur e trupave, një përqaqim që pasqyronte kënaqësinë dhe një unitet që vinte nga kujtimet për afërsinë e kaluar, e cila me patjetër do të kishte qenë e lumtur. Gëzimi rrezatonte prej tyre, veçse tashmë i harresës, i kënaqjes së një instinkti natyror që, ndonëse tani i pakësuar, ende ua mbulonte trupin, por lidhej edhe me gëzimin e injorimit të botës përreth, sak kësaj dite të ftohtë gri, qytetit prozaik me tramvajet dhe pasagjerët e trazuar. Gëzimi i tyre ishte aq i gjallë, në kontrast me pikëllimin e Blamit, saqë, me gjithë dhimbjen që i shkaktoi, ai, mund ta veçonte dhe ta përshfaqte si një objekt të hollë të padepërtueshëm në harmoninë e vet, por që ishte përgjithmonë përtej mundësive të tij. Ai e kuptoi atëherë se Janja ashtu siç ishte në atë moment, ajo që kishte dëshiruar kur po i vinte tashmë në ballë, nuk ishte sjellë kurrë kështu me të; nga ky kuptim,

ankthin e kësaj gjendjeje e pasoi lehtësimi. Pasi, ajo, duke e përqaftuar burrin jashtë në rrugë, në njëfarë kuptimi po largohej prej tij, duke arritur një ideal edhe pse shumë vite më vonë dhe me dikë tjetër, një diçka ideale që edhe Blami e kishte dëshiruar shumë, por pa e kuptuar kurrë dhe që i dha ndjesinë e një lloj ndarjeje sikur të ishte me motrën, lamtumirë me një person krejtësisht të ndryshëm, i huaj për të, që do të zgjidhte deri diku tendosjen dhe tensionin që e kishte rënduar gjithmonë në marrëdhënien e tyre, i ngjashëm me ndjesinë e turpësorisë dhe rrezikut e identifikimit me shitësit në rrugën e “Hebrenjve”, derisa pronarët u zhdukën prej tyre përgjithmonë.

Godina me numrin 1 në rrugën e “Hebrenjve”, ishte e zënë nga një kompani e prodhimit të artikujve prej lëkure, e quajtur “Levi dhe të Bijtë”. Drejtohej nga i biri, Levi, pasi i ati plak, krijuesi i firmës, u kaplua nga sëmundja dhe e kaloi gjithë kohën e mbetur të jetës në apartamentin e sipërm me një kapë të zezë mëndafshi në kokë¹ dhe i mbuluar me një si një qilim udhëtimi tartani mbi gjunjë. (I nipi i Levit

¹ Jarmulkë (që njihet edhe si kipah, kafkore ose kopel) është një kapë pa buzë, e bërë zakonisht prej pëlhure, e që mbahet tradicionalisht nga meshkujt hebrej për të përmbushur kërkesën e zakonshme, që koka të mbulohet. Ajo mbahet nga të gjithë burrat në komunitetet hebreje ortodokse gjatë lutjeve dhe mbetet ende pjesë përbërëse në rekuizitat e tyre qysh nga kohërat e vjetra.

studionte ndërkohë të bëhej farmacist në Beograd). Kur hungarezët marshuan nëpër Novi Sad, ata e konsideruan lëkurën e babait të Levit, thelbësore për përpjekjet e luftës dhe e konfiskuan duke e ngarkuar mbi makinat ushtarake, kurse dyqani i zbrazur u mor nga Julius Melbahu, nga kallfa që shërbeu një kohë të gjatë te Levi, duke e kthyer në një dyqan të profilizuar për çanta lëkure dhe punime galanterie. I biri i Levit, megjithatë, arriti t'ia dalë të fshehtë një pjesë të madhe të lëkurës në pjesën e sipërm të apartamentit dhe, ia ofroi Melbahut me konditën ta ndanin fitimin nga çantat që do të arrinin të prodhoheshin. Melbahu pranoi, e mori lëkurën dhe... e kallëzoi birin e Levit për fshehje të mallrave strategjike që nevojiteshin në luftë. I biri i Levit u arrestua dhe e rrahën kaq keq sa filloi t'i rridhte gjak nga veshkat e dëmtuara. Ai u lirua por arriti të mbijetonte vetëm tetë ditë. Në shtratin e vdekjes e thirri Melbahun dhe e bëri të betohej se do të kujdesej për të atin e sëmurë dhe i premtoi se do t'i paguante nga një monedhë ari në javë për të mbuluar kostot. Marrëveshja u përmbush prej Melbahut, por deri më pranverën e vitit 1944, kohë kur plaku u deportua në një kamp në Gjermani me pjesën tjetër të mbetur të hebrenjve të Novi Sadit. Ai nuk u rikthye më kurrë. (As nipi i Levit dhe as e ëma e të nipit, që iu bashkua në Beograd, s'erdhën më, që kur shpërtheu lufta). Melbahu kërkoi të gjente në katin e sipërm të apartamentit pjesën e mbetur të parave, duke kontrolluar nëpër dërrasat e dyshemesë,

duke gërmuar deri pas mureve, por nuk i gjeti ato dhe, në vjeshtën e të njëjtit vit, u detyrua ta braktiste dyqanin dhe shtëpinë e t'i shpëtonte avancimit të partizanëve të Armatës Sovjetike.

Godina me numër 4 ishte punishtja e rrobaqepësisë të Elijas Elsmanit, një refugjat nga Galicia që fillimisht u largua në Gjermani, pastaj në Austri dhe, përfundimisht në Jugosllavi. Meqë arrinte të fliste në gjuhën polake kishte mundësi të lidhte kontrata me myshterinjtë, kurse e shoqja dhe fëmijët e rritur, njësoj si i ati ishin trupmëdhenj, me sytë si ká dhe hundë të mëdha, por flisnin vetëm gjermanisht. Për këtë arsye, familja e tij - gruaja, dy djemtë dhe dy vajzat bënë punën e qepjes, kurse atij, zakonisht qull në djersë, i duhej të rendte nga njëri klient te tjetri, duke u marrë masat, duke bërë ndryshimet e rastit, duke u përkulur dhe duke gërvishtur, por dhe duke gënjyer gjatë gjithë kohës në mishmashin e tij sllav. Gestapo i kishte të regjistruar Elsemanët si qytetarë gjermanë dhe u kërkoi autoriteteve hungareze t'i dorëzonin, pastaj u përcollën në drejtim të Serbisë, ku u zhdukën në dhomat e gazit. Kur ushtarët hungarezë shkuan në banesë t'i mblidhnin me kërkesën e Gestapos, ata u argëtuan duke i rrethuar Elsmanët dhe, duke i bërë vajzat Elsman të kërcenin cullak, para prindërve dhe vëllezërve, të cilët duhej të këndonin fokstrot dhe vals dhe të mbanin ritmin me duartrokitje.

Në godinën me numër 3 punonte orëndreqësi me emrin Aron Grin, burrë i imët dhe me kurriz. Ai u

urdhërua të ndihmonte në pastrimin e rrënojave nga aeroporti i Novi Sadit, por pas një ataku në zemër vdiq në qershorin e 1941-it. Djali i madh, gjithashtu orëndreqës, u mobilizua në të njëjtin vit dhe u dërgua me punë të detyruar në Ukrainë, ku ngriu për vdekje gjatë luftimeve në Voronezh, ndërsa i biri më i vogël i Grinit, ende nxënës në shkollë, mbeti në shtëpi dhe u ekzekutua bashkë me të ëmën në bastisjen e janarit të vitit 1944.

Në godinën me numër 6, në katin e sipërm, ndodhej zyra avokatore e doktor Aleksandër Verteshit. Ky ishte shumë i varur nga morfina, ndërsa e shoqja vuante nga tuberkulozi dhe s'kishin fëmijë. I ndaluar si komunist, pasi e ngatërruan me dikë me të njëjtin emër, e pyetën dhe e rrahën dy ditë me radhë, por u lirua kur u zbulua se ishte Verteshi i gabuar. Ai u kthye në shtëpi dhe e asfiksoi menjëherë veten dhe të shoqen me gaz në kuzhinë.

Godina me numër 5, në ish-rrugën e “Hebrenjve” i takonte një familje librarësh të pasur nga Zagrebi, të cilët hapën një antikuarat për vëllain e tyre kapelabërës Leon Mordehaji. Pas pushtimit të Hungarisë, Mordehaji dhe familja e tij u deportuan në Kroaci, ku përfunduan në një kamp përqendrimi që administrohej prej ustashësh¹. E shoqja e Mordehajit

¹ USTASH ishte organizatë fashiste dhe ultranacionaliste kroate, e cila veprroi midis viteve 1929 dhe 1945. Njihej zyrtarisht si Ustaša - Lëvizja revolucionare kroate (kroatisht: Ustaša - Hrvatski revolucionarni pokret).

dhe e bija i vdiqën nga dizenteria, por ai, në saje të një zanati të vjetër dikur si shegert për rrobaqepës, mbijetoi dhe duke mos pasur më arsye të kthehej sërish pas lirit, përfundoi në Zagreb. Atje, priti për një vit që anëtarët e familjes së tij të gjerë t'i shfaqeshin ose t'i jepnin ndonjë shenjë jete, veçse kur nuk u duk askush, u kthye pas në Novi Sad dhe iu bashkua një kooperative kapele-bërësish, ku punoi derisa doli në pension, duke mbetur beqar.

Në banesën që mbante numrin 8 gjendej shtëpia e Elsa Baumanit, një gruaje me sy të shtrembër, që qepte kostume banje dhe korse, e veja e një topografi, i cili vdiq i ri nga një inflamacion nervash gjatë Luftës së Parë Botërore. Ajo kishte një djalë të vetëm, student në shkollën profesionale me një trup tejet të hollë, i cili mbante syze dhe kishte buzë të trasha, të çara vazhdimisht. U vranë të dy në bastisjen e vitit 1942.

Banesa me numër 9 i takonte lavanderisë dhe dhomës së hekurosjes së Ernst Mahrerit. Ky i fundit e mësoi zanatin në Vjenë dhe ishte i pari që ofroi në qytet larjen e rrobave dhe shpërndarjen nëpër shtëpitë e myshterinjve të Novi Sadit me një kamionçinë, ku mbi të kishte pikturuar një diell me sy, me faqe dhe, një gojëz që buzëqeshte. Kur kamionçina u kërkua nga forcat pushtuese hungareze, si objekt i nevojshëm strategjik, Mahreri e çoi vetë në kazermën e artilerisë, e parkoi në oborr dhe doli i qetë për të pritur derisa të hartoheshin letrat. Ndodhi që kur oficeri që ishte

dezhurn pa diellin e buzëqeshur dhe emrin e firmës, e qortoi Mahrerin, pasi nuk i kishte pikturuar ndonjë gjë tjetër sipër ose t'ia mbulonte këto. Mahreri iu përgjigj se iu takonte atyre ta bënë, që erdhën t'ia merrnin makinën pa para. I tërbuar, oficeri rrëmbeu pushkën nga supi i rojës, e goditi disa herë Mahrerin me kondak derisa ky ra në kllapi, më pas u ngjit në kabinën e makinës, motori i të cilës ishte ende në punë dhe, e shtypi. Pasi u harruan ngjarjet e kësaj batërdie, oficeri u transferua, e veja e Mahrerit dhe fëmijët u urdhëruan ta linin menjëherë Novi Sadin dhe për këtë i dhanë lejen zyrtare të jashtëzakonshme nga policia. U zhvendos me të birin e bijën në drejtim të Budapestit. Në vitin 1943 i biri u detyrua të shkonte në kampet e punës në minierat e Borit, por arriti t'ia mbathte dhe të bashkohej me partizanët jugosllavë dhe pas lufte u bë oficer në Armatën jugosllave; e veja e Mahrerit dhe e bija u vranë gjatë një demonstrimi force të 'Kryqit me Shigjetë' në geton e Budapestit.

Pronari i dyqanit të këpucëve në banesën me numrin 10 ishte një njeri pedant dhe metodik, që quhej Armin Vajs, më shumë estet sesa tregtar, një dashnor i gjërave të bukura dhe të kushtueshme. Ai ishte i njohur në të gjithë Budapestin për ekspertizën e tij, ndaj menjëherë pas pushtimit, një kompani e Budapestit ofroi t'ia kthejë dyqanin në një degë të tyre dhe ta linin vetë atë si përfaqësuesin e tyre. Arriti të pajisej me letra që dokumentonin marrjen nga një komision i gjithi qeveritar, iu arratis kampit

të punës, ku autoritetet ushtarake përcillnin të gjithë hebrenjtë; arriti dhe i mbijetoi dhe një bastisjeje disa muaj më vonë. Por kur ‘Kryqi me Shigjetë’ erdhi në fuqi në fillim të vitit 1944, Vajsi u deportua në Gjermani bashkë me të shoqen, dy bijat dhe vjehrrën, prej nga ku nuk u kthyen më.

Godina me numër 11 ndahej nga një tregtar llambash Eduard Fikeri dhe një montues sobash Jakob Mentele. Fikeri dhe familja e tij u vranë gjatë një bastisjeje, kurse beqari Mentele, arriti të mbijetojë, por pastaj e la Novi Sadin për Budapestin, ku arriti të sigurojë dokumente false dhe ia doli të mbijetojë nga lufta. Pas lufte mbeti në Budapest dhe vdiq nga kanceri pak vite më vonë.

Godina me numër 13 ishte shitorja e ushqimeve të Artur Shpizerit dhe i gjërave të vogla delikate. Shpizeri ishte futbollist amator dhe shoqërohej me shumë miq jo hebrenj dhe, meqë u martua me një hungareze e pasi u konvertua para luftës, u kursye nga persekutimi. Nuk kishte fëmijë, por e motra i dërgoi të bijën gjashtëvjeçare nga Shteti i Pavarur i Kroacisë, ku hebrenjtë përballnin probleme edhe më të mëdha. Shpizeri e mbajti biznesin derisa ‘Kryqi me Shigjetë’ erdhi në pushtet dhe për pak kohë: certifikata e tij e pagëzimit, por edhe e shoqja kristiane dhe shokët e futbollit e mbrojtën me aq sa mundën. Ama, ditën kur e mbesa po depërtohej, si hebreje, Shpizeri shkoi me të shoqen në stacion për ta shoqëruar duke shpresuar se do ta shpëtonin me letrat që posedonin dhe lidhjet

që kishin. Ata u rrasën të gjithë bashkë me vogëlushen drejt Aushvicit; atje Shpizerin e ndanë nga e shoqja dhe mbesa, porse në fund të gjithë vdiqën.

Nga seksioni pas godinës me numër 12 në anën çift dhe numri 13 në anën tek identifikohet vendi ku mbaron rruga e “Hebrenjve”; këto u shkatërruan pas luftës për t’i hapur udhë Bulevardit të Ri, i cili kryqëzon trungun e rrugës kryesore me një rrugë të gjerë, të hapur, dykahëshe të mbjellë me semaforë. Por në distancë, përtej rrugës kryesore, ekstremiteti i saj i prerë, pika nën pikëçuditjen, është ende e dukshme: një sinagogë e gjatë dhe e izoluar me kupola maure që përdoret herë pas here për koncerte nga Orkestra e Dhomës së Novi Sadit ose ansamblet ardhur nga vende të ndryshme, për shkak të akustikës së saj të famshme dhe mungesës së një kongregacioni.

IV

Pjesa e rrugës së “Hebrenjve” që po i nënshtrohej goditjes së varesë dhe kazmës, ku shtëpitë u shembën për t’i hapur udhë Bulevardit të Ri, ofronte mundësi të papritura për vëzhgim dhe mendim. Ndërsa puna përparonte, mund të kundrohej sesi ndërtesat po humbnin çatitë, muret po shfaqeshin nën qiell me majat e tyre të cinguar, të shpërndara si dordolecë; po pastaj u bënë edhe më të shkurtra dhe më të vockla fare duke u shkrirë nga maja deri te themelet, duke humbur pak e nga pak formën e tyre shtëpiake, njerëzore; ndërsa dyert dhe dritaret u zhdukën për të ekspozuar kurbat dhe kthesat e pa ëndërruara, labirintet si ato enigmat e librave për t’u ngjyrosur, derisa më në fund mbetën vetëm themelet, të zhveshura dhe pa dysheme, si edhe muret e fundit të cilat formonin gati kulisat e skenës së një drame rënieje. Këto muret e fundit të drejta, rreshtuar në të njëjtin rrafsh, por tashmë pa mbështetëse tërthore, e përshfaqën në mënyrën më mbresëlënëse natyrën e përkohshme të banimit njerëzor. Muret qëndronin afër njëra-tjetrës në një si zinxhir blu qielli në rozë, me

zona më të zbehta formash të madhësive të ndryshme, krijuar nga gardëroba që përfaqësohej me sirtarët, komodinat, shtretërit, vendin e fotografive, që kishte qëndruar përballë tyre, duke i mbrojtur ato për vite të tëra nga bloza dhe dielli, me ndonjë si grep, gozhdë ose mbajtëse e cila dilte aty-këtu nga sipërfaqet e tyre, deri diku të lëmuara. Ato paraqisnin sesi çdo shtëpi, madje edhe çdo dhomë në të, individuale apo familjare, ishte unike, e veçantë dhe e plotë, në të cilën të gjithë njerëzit mund të hanin, flinin, lexonin, të bënin dashuri, të betoheshin, të luftonin ashpër për veten dhe sipas mënyrën së tyre dhe në të njëjtën kohë: të gjitha ato veçori realizoheshin me zgjedhje si në afërsinë e tmerrshme të tjetrit, por edhe të ndryshmit, si edhe në afërsinë e plotë të asaj që dikur ngrehina përjashtonte botën, qiellin, shiun, por me të cilët tani pa kursim këto u bashkuan, ashtu si hera-herës do të zhdukeshin dhe shkriheshin.

Blami del në Bulevardin e Ri në kryqëzimin mes dritës të semaforëve, tabelave sinjalizuese dhe mes tymit të tubave të shkarkimit të benzinës. Rruga e mëtejshme i pengohet nga një makinë kafe e çelur me një turi të zgjatur poshtë, mu si zhgualli i breshkës, e cila, duke u tundur, shkel butësisht mbi bordurë dhe ndalon anash diku në fund të ish-rrugës së “Hebrenjve”. Edhe Blami ndalon në mënyrë instinktive. Dera e pasme hapet dhe prej andej shfaqen një palë këmbë të gjata, ngjyrë bronxi të përkulura në

gjunjë ku shfaqet një fustan i ngritur deri te kofshët. Këmbët dhe kërcinjtë e drejtë varen për disa sekonda, semafori në ndryshim reflektohet mbi sandalet e bardha, pastaj zbritet mbi tullat e verdha të ish-rrugës së “Hebrenjve”, ndërkohë gjunjët e bashkuara dhe vendosja e këmbëve përhapen si sfungjer nën peshën e trupit që tani po ngrihet, koka drejtohet sipër dhe drejt e nga dera e hapur e makinës. Është një trup i hollë, që vazhdon me një kokë të zgjatur me tipare normale, sytë e palëvizshëm blu, të qelqtë dhe flokët e zbardhur nga dielli, të mbledhur pa kujdes nën një topuz, që i japin fytyrës një cilësi të pajetë, megjithatë gruaja lëviz në një mënyrë të zhdërvjellët dhe plot vetëbesim. Pastaj qëndron drejt, e tendosur dhe, bën një gjysmë kthimi, veprim nga i cili i tundet fustani i gjelbër pak i rrudhur, që i rri lirshëm, por megjithatë e ka të lidhur në bel dhe kjo ia nxjerr më në pah gjunjët kockorë. Ajo tund dorën që është po aq e nxirë nga dielli sa edhe këmbët, ndërkohë që nga dera shfaqen këmbët e një fëmije me çorape të bardha të shkurtra, pastaj fytyra pikaloshe e tij, sytë e përlotur poshtë syzeve nën rrezet e diellit dhe përfundimisht kjo figurë e vogël, paksa e trullësuar dhe mosbesuese, ecën lëkundasi në rrugë dhe afrohet deri te gruaja. Ajo e rrok djalin për dore, që e mbërthen në mënyrë automatike menjëherë dhe shikon përreth. Sytë e saj të zbehtë bien mbi Blamin, ia ulin mundësinë atij për t’u zbrapsur, më pas enden drejt stendave ku janë shitësit duke ofruar raki rrushi, pllaka gramafoni,